



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/319
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.

Tiranë ___/___/2022

Nr. Dok. 202201224/13

Lënda: *Rekomandime për zbatimin me korrektësi të rasteve dhe kritereve ligjore të shoqërimit, ndalimit/arrestimit të shtetasve nga punonjësit e Policisë së Shtetit dhe trajtimin e tyre me dinjitet në përputhje me aktet normative në fuqi.*

Drejtuar: **Z. Muhamet RRUMBULLAKU**
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

TIRANË

Drejtues i parë Tonin VOCI
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë

TIRANË

Altin LILA
Shef i Komisarariatit të Policisë nr.3 Tiranë

TIRANË

Sikurse ju kemi vënë në dijeni me shkresën nr. K4/Z2-3 prot., datë 20.10.2022, në Institucionin e Avokatit të Popullit është regjistruar rasti i bërë publik në media lidhur me vdekjen e një shtetasi 32 vjeçar pas ndalimit të tij nga Policia e Shtetit. Sipas raportimeve autoritetet kanë ndjekur rreth orës 23.00 të mbrëmjes së dt.19.10.2022 shtetasin Lear Kurti pasi nuk është përgjigjur thirrjes për tu identifikuar më pas qytetari është shoqëruar dhe dërguar në mjediset e komisarariatit nr.3 Tiranë.

Lidhur me ngjarjen Nd/Komisionerët e Institucionit të Avokatit të Popullit përkatësisht Mekanizmit kombëtar për parandalimin e torturës trajtimit të egër çnjerëzor dhe degradues, filluan hetimin administrativ të çështjes. Në dt. 20.10.2022, u krye një inspektim në Komisariatin e Policisë nr.3 Tiranë, në kuadër

të monitorimit të respektimit të të drejtave të njeriut për personat e shoqëruar/ ndaluar nga organet e policisë së shtetit.

Përfaqësuesit e institucionit të Avokatit të Popullit përgjatë inspektimit administruan, deklaratat e punonjësve të policisë të cilët ishin të pranishëm përgjatë shoqërimit të shtetasit Lear Kurti, si dhe siguruan kopje të regjistrit të personave të shoqëruar, ku evidentohen të dhënat personale të personave të shoqëruar.

Në Komisarariatit e Policisë nr. 3 (Tiranë) punonjësit e policisë të pyetur nga ana jonë, deklaruan se në datën 19 Tetor 2022 rreth orës 23:10 është evidentuar një qytetar (Lear Kurti) i cili i është shmangur patrullës së Policisë, duke kryer veprime të dyshimta. Për këtë ai është pyetur nga policët e patrullës nëse është banor i lagjes dhe nëse kishte dokumente identifikimi, por përgjigjet e tij kanë qenë refuzuese duke u larguar me vrap. Patrulla e policisë është vënë në ndjekje, patrulla 1) dhe i ka kërkuar sallës operative, përforcime, të ardhura nëpërmjet patrullës nr. 2, në orën 23:13.

Prej momentit të ndalimit, pasi është kapur në ndjekje, në orën 23:27; patrulla 2 ka njoftuar sallën operative mbi shoqërimin e këtij shtetasi në ambientet e Komisarariatit, pasi ka kundërshtuar punonjësit e Policisë. Pas 7 minutave, në orën 23:34, patrulla 1) i ka kërkuar sallës operative ambulancë pranë Alpinit, pasi personi i shoqëruar ka deklaruar që nuk ndihet mirë. Më tej po kjo patrullë e ka shoqëruar shtetasin L.K për në Ambientet e Komisarariatit nr.3 Tiranë si dhe më pas me makinë policie nga komisarati nr.3, Tiranë e kanë dërguar për në spital. Vlen të theksohet nga ana jonë se në deklaratimet e tyre punonjësit e policisë të cilët kishin kryer shoqërimin e shtetasit L.K e kishin të paqartë dhe kontradiktor faktin e pohimit të përkeqësimit të gjendjes shëndetësore të këtij shtetasi si dhe arsye se përse ky shtetas u shoqërua në ambientet e komisarariatit nr.3 Tiranë dhe nuk iu dha ndihma mjekësore e menjëhershme duke e dërguar në urgjencën e Spitalit Universitar të Traumës pasi dhe distanca nga vendi i shoqërimit drejt spitalit ishte e shkurtër¹.

Referuar ligj.nr. 108/2014 për Policinë e Shtetit, neni 122 pika 1 dhe 2 përcaktohet se: 1. Masat mbrojtëse merren ndaj personit të sëmurë mendor, në gjendje të dehur, nën efektet e lëndëve narkotike ose ndaj personit me sëmundje ngjithëse të rënda. Në këto raste, punonjësi i policisë e dërgon personin në ambientet e policisë, në institucionet shëndetësore, në qendrat e rehabilitimit ose e dorëzon te kujdestari apo personat përgjegjës. 2. **Punonjësi i policisë merr masat e nevojshme për mbrojtjen e personit, gjendja e të cilit tregon qartë se nuk mund të kontrollojë veprimet dhe sjelljen e tij dhe për këtë arsye mund t'i shkaktojë dëmtime fizike ose të përbëjë rrezik për jetën e tij ose të të tjerëve.** Gjithashtu neni 109 përcakton

¹Rregullore e Policisë së Shtetit, neni 120 Normat e sjelljes gjatë detyrës/shërbimit, pika 6, “Punonjësi i Policisë së Shtetit, kujdeset që personave të sëmurë apo të plagosur, t’u ofrohet përkuqdesje mjekësore”;

se punonjësi i policisë bën shoqërimin e personave në ambientet e Policisë ose institucionin urdhërdhënës në kushtet dhe rastet e mëposhtme:

- a) kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente;
- b) për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës ose ndonjë detyrimi të përcaktuar me ligj;
- c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer veprë penale;
- ç) për të parandaluar kryerjen e një veprë penale;
- d) kur është larguar pas kryerjes së një veprë penale;
- dh) për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, sipas kushteve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale;
- e) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose shoqërimin e tij në organin kompetent;
- ë) kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë;
- f) për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose ekstradimit.

Duke mbajtur në konsideratë natyrën e çështjes, në raste të tilla shërbimet e policisë, mund ta parandalonin këtë ngjarje, në kushtet e veprimeve apo mosveprimeve që përfaqësuesit e rendit publik kishin si detyrim të kryenin.

Nisur nga këto deklaratime si dhe duke iu referuar nenit 109 të ligjit të sipërcituar, rezulton se punonjësit e policisë kanë vepruar në kundërshtim me dispozitën e mësipërme, sepse nuk mund të bëhet shoqërimi i një personi duke u mbështetur vetëm në dyshime të pa arsyeshme. Sipas dispozitës së cituar, dyshimet duhet të jenë të arsyeshme, për kryerjen e një krimi, për të parandaluar kryerjen e një veprë penale, ose për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime (pikat 'c' dhe 'ç' parashikojnë se në rastin konkret, nuk ndodhemi as para shoqërimit, ndalimit dhe as para arrestimit në flagrancë, që parashikon Kodi i Procedurës Penale (KPP). Në këto rrethana, punonjësit e Policisë kanë vepruar në kundërshtim me nenin 27 të Kushtetutës dhe nenit 5 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), që parashikojnë rastet kur mund të kufizohet liria e personit.

Gjithashtu u krye këqyrja e regjistrit të shoqërimit ku duhet të pasqyrohen rastet e shoqërimit. Gjatë këqyrjes së dokumentacionit të sipër përmendur, rezultoi se shtetasi Lear Kurti nuk ishte i evidentuar në këtë regjistër pas shoqërimit të tij në ambientet e komisariatit. Bazuar në rregullat e shoqërimit të personave në ambientet e komisariatit duhet mbajtur procesverbali i dokumentimit të veprimeve të kryera me personin e shoqëruar pas kryerjes së veprimeve të verifikimit e sqarimit

të rastit për personin, nga punonjësi i policisë, si dhe dokumentimi i të dhënave, gjeneraliteteve të shtetasit për kohën hyrjes dhe qëndrimit të tij në Komisarjat, cilësinë dhe shkaqet ligjore të kufizimit të lirisë². Konkretisht në Procedurat Standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 938, datë 24.07.2019, në kapitullin VIII parashikohet se:

“Akti/veprimi i shoqërimit, detyrimisht, evidencohet e dokumentohet në sistem elektronik, në regjistra, në formularë dhe procesverbale.

Procedurat e evidentimit të veprimeve që janë kryer me të shoqëruarin kryhet nga punonjësi i policisë që ka punuar dhe sqaruar çështjen, ndërsa hedhja e të dhënave në regjister dhe në sistemin elektronik të të dhënave kryhen nga punonjësi i policisë të shërbimit të informacionit në njësinë policore.

Mos zbatimi i kësaj kërkesë nga personat përgjegjës për dokumentimin e aktit të shoqërimit, përbën shkelje të rëndë disiplinore.

1. Evidentimi i veprimeve dhe të dhënave, që kryhen me personat e shoqëruar bëhet në rrugë:

a. Manuale,

b. Elektronike.

a. Dokumentimi i të dhënave në rrugë manuale kryhet në:

a.1 - Regjistrin e Evidentimit të të Dhënave për Personat e Shoqëruar (lidhja 1),

a.2- Formularin e Raportit të Shoqërimit (lidhja 2),

a.3 - Proces verbalin e veprimeve të kryera me personin e shoqëruar (lidhja 3).

a.1.1- Hedhja e të dhënave në Regjistrin e Evidentimit të të Dhënave për personat e Shoqëruar kryhet nga punonjësi i shërbimit të funksionit: ndihmës specialist për informacionin të strukturave të rendit publik të njësisve policore.

²VII. “Procedura të dokumentimit të veprimit të shoqërimit”

a.3 - Proces verbali i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar:

a.3.1 - Pas kryerjes së veprimeve të verifikimit e sqarimit të rastit për personin e shoqëruar, nga punonjësi i policisë hartohet procesverbali i dokumentimit të veprimeve të kryera me personin e shoqëruar.

a.3.2 - Ky procesverbal pasi plotësohet duke hedhur të gjithë të dhënat sipas përcaktimeve dhe rubrikave të përcaktuara në të, nënshkruhet në fund të çdo faqeje nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe nga vetë personi i shoqëruar.

a.3.3 - Proces verbali i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar plotësohet nga punonjësi i policisë që është ngarkuar të kryejë verifikimin dhe trajtimin e çështjes përkatëse për personin e shoqëruar.

a.3.4 - Procesverbali hartohet në dy kopje, një kopje e procesverbalit i jepet detyrimisht personit të shoqëruar dhe kopja tjetër dorëzohet në sekretari/arshivën e njësisë policore.

Këto të dhëna hidhen menjëherë dhe pa vonesë në regjistër pas mbërritjes/shoqërimit të personit nga punonjësi i policisë dhe akomodimit të tij në ambientet e shoqërimit”.

Sikurse rezulton në mënyrë të qartë nga përmbajtja e kësaj procedure, evidentimi e veprimeve dhe i të dhënave që kryhen në mënyrë manuale me personat e shoqëruar, bëhet në Regjistrin e Evidentimit të të Dhënave për Personat e Shoqëruar (lidhja 1) dhe jo në regjistra të tjerë. Regjistrimi në këtë dokument është me rëndësi sepse pikërisht tek ky regjistër, janë përcaktuar rubrikat e gjeneraliteve, shkakut ligjor të shoqërimit, emrit të punonjësit të policisë që ka bërë shoqërimin. Përveç sa më lart, janë përcaktuar edhe disa rubrika të tjera shumë të rëndësishme që lidhen me trajtimin dhe respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, sikurse janë njoftimi i familjarëve. Parashikimi i këtyre rubrikave përcakton detyrimin e punonjësit të policisë t’i plotësojë ato, ndërkohë kjo krijon edhe mundësinë e verifikimit të respektimit të të drejtave të të shoqëruarve nga organet e kontrollit të brendshëm apo të jashtëm. Ndërsa mos plotësimi i Formularit të Raportit të Shoqërimit ndaj personit të shoqëruar si më sipër, vjen në kundërshtim me pikën a.2.1 të kapitullit VIII të kësaj procedure ku parashikohet se:

“Formulari i Raportit të Shoqërimit plotësohet nga punonjësi i policisë që ka kryer shoqërimin e personit, menjëherë pas shoqërimit të personit në ambientet e policisë/ambientet e shoqërimit”.

Avokati i Popullit vlerëson të sjellë në vëmendje rëndësinë e veçantë që ka sjellja e organeve të shtetit kundrejt personave të shoqëruar, që në orët e para të shoqërimit. Një person i shoqëruar nga policia është në një situatë të cënueshmërisë së veçantë, pasi personi është plotësisht në duart e agjentëve të zbatimit të ligjit. Ky çekuilibër pushteti krijon një situatë rreziku ku mund të ndodhin abuzime dhe tortura.

Masat mbrojtëse, veçanërisht në fazat e hershme të shoqërimit, janë thelbësore për të parandaluar abuzimet. Këto masa përfshijnë:

- dhënien e informacionit të të shoqëruarve për të drejtat e tyre;
- sigurimin e aksesit te një avokati;
- njoftimin e anëtarëve të familjes dhe/ose një palë të tretë për personin;
- ***dhënien e ekzaminimit nga një mjek për të konfirmuar ose përjashtuar pretendimet për keqtrajtim dhe për të ofruar ndihmë mjekësore nëse është e nevojshme.***

Po kështu, Rezoluta 31/31³ të vitit 2016 i inkurajoi shtetet të mbajnë azhurnuar regjistrat zyrtarë të personave në mbikëqyrje policore që, përmbajnë të paktën informacione për:

a) arsyet e arrestimit

b) kohën e arrestimit dhe dërgimit të personit të arrestuar në një vend ndalimi, si dhe paraqitjen e parë para një organi gjyqësor ose autoriteti tjetër

c) identitetin e zyrtarëve të zbatimit të ligjit në fjalë, dhe

d) informacione të sakta në lidhje me vendin e ndalimit.

Lidhur me hetimin administrativ të rastit Avokati i Popullit i është drejtuar me kërkesë për informacion institucioneve: Drejtorisë së përgjithshme të Policisë së shtetit me shkresën K4/Z2-3 “Kërkesë për vënien në dispozicion të pamjeve filmike të kamerave”, Spitalit Universitar të Traumës me shkresën K4/I77-5 “Kërkesë për vënien në dispozicion të kopjes së kartelës mjekësore të shtetasit L.K” Prokurorisë së rrethit gjyqësor Tiranë me shkresën K4/I77-6 “Kërkesë për dokumentacion dhe informacion”, Institutit të Mjekësisë Ligjore me shkresën K4/Z2-4” Kërkesë për vënien në dispozicion të kopjeve të ekspertizës mjeko-ligjore të shtetasit Lear Kurti”, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore “Kërkesë për shpjegime”. Sa më sipër në përgjigjen e tyre institucionet na bëjnë me dije se:

Me shkresën nr. 2355/1 Prot datë 25.10.2022 kthim përgjigje, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore na bën me dije se, me marrjen dijeni të ngjarjes kanë kryer veprime procedurale nën drejtimin e organit procedural të hetimit dhe materialet janë referuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Më shresën nr.14711/1 Prot datë 31.10.2022, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë na konfirmon se: Prokuroria pranë Gjykatës së shkallës së Parë Tiranë, mbi bazën e materialit kallëzues të ardhur nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, në datë 22.10.2022, ka regjistruar procedim penal nr.7671 që bën fjalë për veprat penale “Kryerja e veprimeve arbitrare” dhe “Mosdhënia ndihmë” parashikuar si vepra penale nga nenet 250 dhe 97 i Kodit Penal. Në kuadër të veprimeve hetimore lidhur me këtë procedim penal, është kërkuar me vendim kryerja e ekspertimit mjekoligjore të shtetasit (viktimës) Lear Kurti, akt i cili nuk është administruar akoma. Gjithashtu prokuroria na bën me dije se është kërkuar me vendim kryerja e ekspertimit teknik, lidhur me pamjet filmike të administruara në kuadër të këtij procedimi, akt i cili ende nuk është administruar.

Me shkresën nr.9222/6 Prot datë 16.11.2022 kthim përgjigje, Instituti i Mjekësisë ligjore përkatësisht sektori i menaxhimit të akteve të ekspertimit dhe laboratorit ka përcjellë “Aktin e Ekspertimit” bashkëlidhur1. Aktin e ekspertimit Mjeko-Ligjor Nr.4 fl, 2. Deklaratë eksperti 3. Faturë arkëtimi me nr.7475. Në konkluzionet e ekspertit mjeko ligjor konstatohet se shkak i vdekjes së shtetasit Lear Kurti ka qënë

³ https://ap.ohchr.org/documents/dpage_e.aspx?si=A/HRC/31/L.26/Rev.1

helmimi (mbi dozim) akut me lëndë narkotike të llojit kokainë, i komplikuar me shok toksik, me mekanizmin e Ishemisë akute të miokardit që ka sjellë për pasojë asistolinë kardiake (ndalimi i menjëhershëm i punës së zemrës). Sipas ekspertizës vdekja e shtetasit L.K nuk ka ardhur për shkak të ndonjë veprimi të dhunshëm nga ana e Policisë së Shtetit.

Me shkresën nr.3858/3 Prot, datë 26.10.2022, kthim përgjigje nga Drejtoria e Përgjigje e Policisë së Shtetit përkatësisht, Departamenti për Sigurinë Publike ka dërguar pranë Institucionit të Avokatit të popullit DVD me pamjet filmike të kamerës së sigurisë të Komisarariatit të Policisë nr.3 Tiranë , në DVP Tiranë, për datën 19.10.2022, theksojmë se nga këqyrja e këtyre pamjeve ato nuk janë të plota në të gjitha ambientet e Komisarariatit.

Nga këqyrja e këtyre pamjeve nga Nd/komisionerët e avokatit të Popullit, pamje filmike të korridorit hyrës të derës kryesore në komisarariat vërehet se: Patrulla ka sjellë në komisarariat shtetasin Lear Kurti i cili në duar mban pranga, i shtrirë në tokë në gjendje të keqe shëndetësore me dridhje trupi. Në këto pamje duken punonjësit e policisë të cilët përpiqen ti japin ndihmë, shtetasi L.K ka qëndruar në ambientet e komisariatit për 4 minuta dhe më tej është marrë nga patrulla e cila edhe e kishte shoqëruar më herët.

Gjithashtu në mungesë të pamjeve filmike, kemi administruar pamjet të publikuara në media <https://www.youtube.com/watch?v=oCXcaHZog0o>, Media “Euronews Albania” në të cilën shfaqen pamjet e para të momentit e kapjes së personit L.K dhe neutralizimi i tij pas ndjekjes nga policia për afërsisht 200 metra nga momenti i parë i komunikimit me të. Në këto pamje qartazi duket gjendja e rënduar shëndetësore e shtetasit L.K i cili është i ulur në tokë dhe i pafuqishëm për tu ngritur si dhe punonjësit e policisë që tentojnë ta shoqërojnë. Koha e qëndrimit në këto kushte deri në momentin e futjes së tij në makinën e policisë është afërsisht 7 minuta. Lidhur me këtë çështje, Institucioni i Avokati të Popullit⁴ ka mbajtur një qëndrim në media duke pasqyruar qartazi problematikat e evidentuara përgjatë shoqërimit të shtetasit L.K. Sa më sipër është e përcaktuar qartë në rregulloren e Policisë së Shtetit se, në aspektin organizativ dhe funksional parashikohet: a) Riorganizimi i mënyrës së mbulimit të territorit në funksion të “zonës policore funksionale” - ndarje (një apo disa lagje) të territorit të çdo komisaritati/stacioni policor. Çdo zonë policore do të mbulohet me një bërthamë të integruar të të gjitha shërbimeve të policisë përgjegjëse (oficeri i policimit në komunitet, patrulla e përgjithshme, policia rrugore dhe punonjësit e strukturës të krimeve) për atë zonë, me një përbërje lehtësisht të ndryshme sipas karakterit urban apo rural të zonës. Veprimtaria e kësaj bërthame, që do të ankohet në mënyrë permanente dhe të dukshme në çdo zonë, do të plotësohet dhe asistohet me struktura të lëvizshme që veprojnë në funksion të problematikës.

⁴ <https://dosja.al/aktualitet/avokatja-e-popullit-tregon-detaje-bombe-policia-nuk-ka-regjistruar-ar-i251969>.

Me shkresën nr.2430/1.Prot datë 26.10.2022 kthim përgjigje, Spitali Universitar i Traumës na bën me dije se , pacienti Lear Kurti është dërguar në urgjencën e spitalit nga forcat e policisë në dt.19.10.2022 ora 23.40. Pacienti u morr menjëherë në sallën e urgjencës ku u konstatua se ishte pa shenja jetësore, “Exitus Letalis” ora 00.10 dt. 20.10.2022.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut, nga administrata publike”, dhe në nenin 21/ç të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se: “i rekomandon prokurorisë të fillojë hetime në qoftë se vëren se është konsumuar figura e një vepre penale”:

Në vlerësimin e institucionit të Avokatit të Popullit shkaqet e ndodhjes së kësaj ngjarjeje dhe problematikat e konstatuara janë:

- ✓ *arsyeja e ndalimit të 32-vjeçarit, e cila solli më pas pasojat e saj.*
- ✓ *mos veprimit nga punonjësit e policisë për dërgimin e menjëhershëm të personit të shoqëruar L.K në spital pas shfaqjes së simptomave të përkeqësuar shëndetësore.*
- ✓ *mungesës së dokumentacionit, pasi është i mangët në komisarjat për kohën e qëndrimit dhe shkaqet e kufizimit të lirisë. Mungon mbajtja e një procesverballi për pasqyrimin e rrjedhën e ngjarjeve.*

Është rasti të theksojnë se këto shkelje e të drejtës ligjore të të shoqëruarve nga punonjësit e policisë dhe e detyrimit të këtyre të fundit është evidentuar edhe më parë nga ana jonë. Ndonëse në disa rekomandime që u janë adresuar në vijimësi nga institucioni i Avokatit të Popullit strukturave vendore e qendrore të Policisë së Shtetit janë trajtuar këto shqetësime dhe është rekomanduar përmirësimi i punës dhe, me keqardhje konstatojmë se raste të tilla përsëriten në praktikën e përditshme.

Ky fakt tregon se nuk njihen në nivelin e duhur aktet normative ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e Policisë së Shtetit dhe detyrimet e punonjësve të policisë për të zbatuar e respektuar të drejtat e shtetasve të shoqëruar në mjediset e Policisë së Shtetit.

Gjithashtu vlerësojmë se një ndër shkaqet e përsëritjes së këtyre shkeljeve të të drejtave të qytetarëve është mos instruktimi i vazhdueshëm dhe mos ushtrimi i kontrollit të strukturave drejtuese të punonjësve të policisë ndaj vartësve të tyre.

Theksojmë se qëndrimet jo ligjore të mbajtura në këto raste nga punonjësit e policisë cenojnë rëndë imazhin e Policisë së Shtetit dhe besimin e publikut tek ky organ, të cilat janë të domosdoshme në kryerjen me sukses të misionit ligjor të saj për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike.

Avokati i Popullit në përmbushje të misionit ligjor të parashikuar në nenin 2 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, *si nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend*, gjykon se bazuar në evidentimin e problematikave të lartpërmendura, lind nevoja e një reagimi më të fortë nga strukturat e Policisë së Shtetit, për të garantuar respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të shtetasve të shoqëruar nga punonjësit e policisë në orët e para të shoqërimit.

Rekomandime

1. Marrjen e masave për zbatimin efektiv të garancive ligjore të qytetarëve në lidhje me ruajtjen e shëndetit dhe të mirëqenies së tyre në momentet e para të shoqërimit nga Punonjësit e Policisë.
2. Marrjen e masave të nevojshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për të ushtruar kontroll në mënyrë të vijueshme në të gjitha strukturat vendore të policisë lidhur me zbatimin e kritereve të shoqërimit të shtetasve dhe respektimin e të drejtave ligjore të personave të shoqëruar si dhe ushtrimit nga titullarët të kërkesave rigoroze llogarie për zbatim të procedurave në rastet e shoqërimit të personave.
3. Marrja e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit që çdo shoqërim i personave në ambientet e policisë së shtetit të jetë i arsyeshëm dhe të ketë indiciet e duhura bazuar në ligjin për policin e shtetit i cili ka përcaktuar qarte rastet kur personat shoqërohen në ambientet e Policisë së Shtetit.
4. Përgjithësimin e këtij rasti në të gjitha strukturat vendore të Policisë së Shtetit, me qëllim mos përsëritjen e shkeljeve të tilla në të ardhmen nga punonjësit e policisë.
5. Marrjen e masave të nevojshme për zbatimin e detyrimeve ligjore për plotësimin e Formularit të Raportit të Shoqërimit në çdo rast shoqërimi të shtetasve **sapo** ata sillen në organin e Policisë.
6. Për shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe qëndrimin që do të mbani ndaj tij, lutemi të vihem në dijeni brenda një afati të përshtatshëm.

KOMISIONER

Ahmet Preçi

